

E PRANOJMË NJËRI-TJETRIN



PA DALLIME

NDIKIMI YNË NË DEMOKRACI

ANES (12), AMRA (13), VULLNET (13), LIZA (11), BLENDAR (12), MUHAMED (12), SARA (12),
DRENUSHA (12), RITA (12)

Ne nxënësit e klasës VII-1 kemi vendosur t'iu informojmë për demokracinë, llojet dhe elementet e saj. Por, mbi të gjitha për ndikimin tonë në demokraci

Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli, i cili e ka fuqinë më të madhe. Qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e vet të cilët janë deputetët, përmes votave të tyre. Kjo do të thotë se demokracinë e formojmë ne. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. Demokracia ndahet në dy forma, ato janë: e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në demokraci presidenciale dhe atë parlamentare. Demokracia e drejtpërdrejtë ndodh në ato vende ku çështjet zgjedhen në mënyrë të dre-

jtpërdrejtë. Kurse, në demokracinë përfaqësuese, populli i zgjedh përfaqësuesit me anë të votave dhe ata pastaj udhëheqin shtetin.

Elementet e demokracisë janë: solidariteti, liria, toleranca, e drejta e të shprehurit të mendimeve, paqja, barazia, etj. Ne, në demokraci mund të ngrisim zërin për gjërat që na duken të padrejta dhe mund ta votojmë personin i cili ne mendojmë se do të bëjë ndryshime për të mirën tonë. Po ashtu, ne duhet të respektojmë ligjet, si dhe duhet të arsimohemi dhe të edukohemi për një të ardhme më të mirë. Vetëm kështu mund të arrijmë shumë e shumë gjëra të tjera pozitive.

Për fund kemi një mesazh për të gjithë moshatarët tanë, e ai është: „Demokracia siguron të ardhmen tonë dhe ne mund të flasim lirshëm në demokraci“.



Cili është elementi më i rëndësishëm i demokracisë për ty Sara dhe pse?



Bledari duke diskutuar me Sarën

Demokracia ka disa elemente, por elementi më i rëndësishëm për mua është barazia. Të gjithë duhet të jenë të barabartë në çdo ambient, si në shkollë, në rrugë, në familje, etj.



Sara duke shprehur mendimin e saj

RËNDËSIA E VOTËS

RINESA (12), AGNESA (12), KRON (11), GETOAR (12), MAIDA (12), ERBORA (12), ANISA (12), BERNA (12),
HUVEJD (12)

Vendet të cilat kanë udhëheqje demokratike, si element bazë të demokracisë i kanë zgjedhjet. E çka janë zgjedhjet? Sa lloje të zgjedhjeve kemi dhe pse ne fëmijët duhet të jemi të informuar për to?

Vendi ynë Kosova, është një shtet i cili vonë e fitoi Pavarësinë e tij. Nga historitë që na kanë treguar familjarët tanë dhe nga ajo që e mësojmë në shkollë, qytetarët e Kosovës nuk i kanë gëzuar të gjitha të drejtat që qytetarët e të gjitha vendeve të tjera demokratike i gëzojnë.

Ne shpresojmë që ju veç e dini që në vendet ku nuk është demokracia si sistem udhëheqës, qytetarët e tyre kanë shumë pak të drejta, ose thënë më mirë këto të drejta janë shumë më të kufizuara. Në shtetet me udhëheqje diktatoriale, qytetarët janë shumë të kufizuar. Ata janë të detyruar të votojnë me apo pa dëshirën e tyre vetëm për një grup të caktuar të personave, ose nuk votojnë fare. Kjo ngaqë shtetet që kanë udhëheqje të tillë, nuk kanë spektër të gjerë politik dhe nuk kanë të drejtë të kandidojnë parti të tjera, përpos asaj që

e ushtron pushtetin. Ndërsa, në vendin tonë është e kundërta e asaj që cekëm më lart. Të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin zgjedhor. Ata janë të lirë të zgjedhin nga mes i shumë kandidatëve, sepse në vendin tonë kandidojnë më shumë se dy parti. E kjo shokë e shoqe është demokracia. Ajo do të thotë zgjedhje ku vetë qytetarët janë të lirë të zgjedhin më të mirin. Këto janë zgjedhje të lira, e jo të imponuara.

Në Kosovë, çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare mund të votojë për: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për kryetarin e komunës dhe asamblistët. Kurse, në ato qendrore, qytetarët votojnë kandidatët për deputetët. Këta të fundit ndryshe njihen si përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Kosovës.



Beni ka të drejtë të zgjedhë për atë që ai ka nevojë më së shumti



Ne, të lirë të zgjedhim atë detyrë që mendojmë që e bëjmë më së miri



Ndërsa, këtu kemi paraqitur se si duket një vendotim në ditën e zgjedhjeve

Të dashur lexues, ne kemi një mesazh për të gjithë ju. Ju jeni e tashmja jonë, andaj iu ftojmë që të punoni dhe të veproni në të mirë të vendit. Ne jemi e ardhmja juaj, prandaj do të punojmë për ju, ashtu siç ju jeni munduar për ne.

Të gjithë së bashku, le të mundohemi bashkë që të bëjmë vendin tonë më të mirë dhe le t'i japim ngjyrë vendit tonë. Ne të gjithë e meritojmë një jetë më të mirë, kështu që le të punojmë për të.

Ajo çka na mbetet neve si nxënës është të shpresojmë që të gjitha këto që i kemi thënë të zënë një vend të veçantë në mendjet dhe zemrat tuaja, lexues.



E ardhmja do të jetë në duar të sigurta, sepse ne e kuptojmë rëndësinë e votës

AKTIVIZOHEMI PËR SHTETIN TONË

BLEDI (12), VERA (13), RREZARTA (12), MELOS (12), SARA (12), NIDA (12), DASTIN (12), ATIK (12),
LEONITA (12)



Ka shumë mënyra se si mund të jemi aktiv dhe të kontribuojmë në demokracinë e shtetit tonë

Një ditë, unë dhe shokët e mi dolëm të shëtisim. Duke ecur, kemi parë një mur në të cilin ishin të shkruara shumë fjalë të papërshtatshme. Neve kjo na bëri përshtypje dhe nuk u ndjemë aspak mirë.

vitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin dhe rritjen e demokracisë.

Andaj, ne ftojmë të gjithë qytetarët e Kosovës që të merren me aktivitete të ndryshme, sepse duhet ta bëjmë Kosovën një shtet të mbarë dhe me standarde Evropiane.



Menduam dhe diskutuam me njëri-tjetrin. Më pas, erdhëm në një përfundim. Mblodhëm disa para dhe së bashku blemë disa ngjyra. Ato ngjyra i përdorëm që ta vizatnim pikërisht atë mur. Vendosëm të vizatnim pëllumba, fëmijë të lumtur dhe ambient të pastër. Kështu që, kur njerëzit të kalonin andej, ta kuptonin demokracinë dhe elementet e saj përmes vizatimit. Një njeri që kaloi në atë rrugë na përgëzoi për punën që bëmë. Unë dhe shokët e mi u ndjemë shumë mirë që kontribuam për shtetin tonë. Pas këtij aktiviteti, ne si qytetarë aktiv që jemi, zhvilluam edhe shumë akti-



Gazetarë aktiv dhe demokratikë

Mësoni se cilat janë të drejtat tona si qytetarë të një shteti demokratik, siç është Kosova. Mirëpo, mësoni edhe përgjegjësitë që na takojnë



Mbrojtja e ambientit dhe kujdesi ndaj njëri-tjetrit vetëm sa na bëjnë neve qytetarë aktiv dhe të interesuar për vendin tonë

Është shumë e rëndësishme të dijmë të zbatojmë të drejtat tona, si dhe t'i dijmë përgjegjësitë që na takojnë, përkundrejt këtyre të drejtave. Kur kemi fjalën për të drejtat tona duam edhe t'i numërojmë disa nga to. Disa nga të drejtat tona më të rëndësishme janë: e drejta e shkollimit, e drejta e votës, e drejta e shprehjes së lirë, etj. Falë këtyre të drejtave, ne jemi shumë të lumtur dhe ndjehemi të rëndësishëm e të respektuar. Megjithatë, mos të harrojmë lexues të dashur se ne kemi edhe përgjegjësi. Këto përgjegjësi i kemi ndaj shtetit tonë. Disa nga këto përgjegjësi janë: ruajtja e ambientit, respektimi i ligjit, ruajtja e pronave publike, pjesëmarrja në zgjedhje, etj.



Sara gjatë punës në grup




Puna vullnetare e qytetarëve e ndihmon të ardhmen e shtetit. Andaj, të bëjmë punë vullnetare për të mirën e komunitetit

RESPEKTIMI I LIGJEVE NË KOSOVË

LEON (12), VENIS (12), MUHAMMED (13), ELITA (12), TEUTA (12), BLEARTA (12), FATBARDHA (12),
VERONIKA (12), AULONA (12)

Roli i Kuvendit në një shtet demokratik

Kuvendi i Kosovës është një institucion shumë i rëndësishëm për popullin e Kosovës. Ky institucion përbëhet prej 120 deputetëve të zgjedhur me votën e lirë. Tri funksionet kryesore të Kuvendit të Kosovës janë: miratimi ose jo miratimi i ligjeve apo funksioni legjislativ, mbikëqyrja e Qeverisë apo funksioni kontrollues, si dhe përfaqësimi i popullit apo funksioni përfaqësues. Deputetët janë të zgjedhur nga votimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve të Kosovës dhe si të tillë ata përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron kompetencat e tij në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Kosovës. Këto janë disa informata rreth Kuvendit. Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e këtij institucioni, vazhdoni dhe lexoni artikullin në vijim.



Ta njohim vendin e ligjeve



Jetojmë në një vend, ku të gjithë mund t'i shprehim mendimet tona dhe kjo na bën të lumtur



Ne i zgjedhim, ata na përfaqësojnë



Gazetarët e ardhshëm

Të gjitha të drejtat i kemi të garantuara me ligj, por përgjegjësia jonë është të jemi të respektueshëm ndaj tyre dhe t'i përdorim elementet e demokracisë në mënyrën më të mirë të mundshme

Vendimet për ligje merren pikërisht në Kuvend. Ligjet janë rregulla, të cilat duhen të respektohen dhe të zbatohen, sepse ato veçse na rregullojnë jetën tonë dhe na bëjnë jetën më të sigurt. Po të mos kishte ligje në një shtet, do të shkaktoheshin probleme të mëdha dhe nuk do të kishte drejtësi. Marrim shembull, Vesa respekton të gjitha rregullat të cilat ndikojnë në punën e saj, si dhe është mjaft e përgjegjshme për veprimet e saja. Ajo shkon me orar në punë, merr punën me seriozitet dhe respekton kolegët e punës. Me një fjalë, ajo respekton vendin e punës. Që shteti ynë të jetë i zhvilluar maksimalisht, ne duhet të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin dhe të tregojmë përgjegjësi për veprimet tona. E gjithë kjo është një mesazh shumë i mirë për të gjithë njerëzit.



Drejtësia në vendin tonë




Ardhmëria e vendit jemi ne





Kushtetuta, ligj mbi ligjet



Grupi duke punuar



Ne kemi shumë të drejta në demokraci



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Eqrem Çabej“
Klasa: VII-1
Vendi: Mitrovicë